**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr[1] i prokurimit** | **KRURGJA-23-11317-2-1-1** |
| **Nr. i brendshëm** | |

**Sa i përket tenderit për: Mirëmbajtja servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a**

**ANKESË**

**1. Identifikimi i ankuesit**

***GAZMEND BOJKU B.I***
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

***RR. "BETEJA E KOSHARES"***
*(Adresa)*

***PEJË*** — ***30 000***
*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

***+38345500 800*** — ***N/A***
*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

***Gazmend BOJKU***
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

***bojku.hidraulik@yahoo.com***
*(Adresa elektronike)*

*(Nënshkrimi i ankuesit)*

***05.07.2024***
*(Data e parashtrimit të ankesës)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Data e njoftimit për kontratë: 01.11.2023<br>Hapja e ofertave: 18.12.2023<br>Njoftimi mbi vendimin e AK-së:18.01.2024<br>Kërkesa për rishqyrtim dt.20.01.2024<br>Vendimi Për Refuzim dt.24.01.2024<br>Ankesa në OSHP dt.02.02.2024<br>Vendimi i OSHP dt.28.05.2024 Nr.2024/0094<br>Njoftimi mbi vendimin e AK-së:26.06.2024<br>Kërkesa për rishqyrtim dt.28.06.2024<br>Vendimi Për Refuzim dt.02.07.2024 |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒ x

| |
|---|
| Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi. |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

| |
|---|
| Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim. |

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

| |
|---|
| **Neni 1 i LPP-së**<br>**Neni 7 i LPP-së**<br>**Neni 52 i LPP-së**<br>**Neni 56 i LPP-së**<br>**Neni 59 i LPP-së**<br>**Neni 60 i LPP-së**<br>**Neni 62 i LPP-së**<br>**Neni 69 i LPP-së**<br>**Neni 72 i LPP-së**<br>**Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik**<br>**Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik** |

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

| |
|---|
| |

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.01.11.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 18.12.2023 ku kanë qenë tre ofertues.
Fillimisht Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me dt. 18.01.2024 ku ishte anuluar ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar.
Kërkesa për rishqyrtim ishte parashtruar me dt.20.01.2024, kurse Vendimi Për Refuzim ishte nxjerr me dt.24.01.2024
Ankesa në OSHP ishte dorëzuar me dt.02.02.2024, kurse ekspertiza ishte lëshuar me dt.07.03.2024, ku ishte aprovuar ankesa si e bazuar dhe lënda ishte rekomanduar të kthehet në rivlerësim.
Vendimi i OSHP ishte lëshuar me dt.28.05.2024 Nr.2024/0094 ku ishte aprovuar ankesa si e bazuar, kurse lënda ishte kthyer në rivlerësim.

Pas rivlerësimit është nxjerr njoftimi mbi vendimin e AK-së me dt.26.06, ku përsëri është anuluar ky aktivitet i prokurimit ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

- *Tenderi i juaj* është i papërgjegjshëm pasi qe nuk e keni permbushur piken 2 te kerkeses së Kapacitetit teknik dhe profesional si ne vijim:

➢ *Ju keni prezentuar kontrat e mbi qirane e lidhur me 01.12.2023 me N.T.SH AUTOSERVIS CHAMPION.*
*Sipas paragrafit III i kesaj Kontrate mbi qirane.qe Qiramarresi NTP,,BOJKU HIDRAULIK'' ka për obligim qe per çdo muaj ta bëjë pagesen e qiras në vlerë prej 350 euro dhe obligimet komunale te puntoris se Qiradhenesi N.T.SH. AUTOSERVIS CHAMPION dhe*
*Paragrafit IV i kesaj Kontrate mbi qirane.*
*Qiradhenesi N.T.SH. AUTOSERVIS CHAMPION eshte i obliguar qe nga data 01.12.2023 ta liroj lokalin (PUNTORINE MEKANIKE), siq eshte kerkuar nga qiramaresi NTP,,BOJKU HIDRAULIK'' gjate bisedes verbale qe keni pas mes veti qe ne punetori te jene paisjet e nevojshme per kontrollimin dhe rregullimin e automjeteve te lehta dhe te renda*

- *Bazuar ne keto paragrafe i eshte kerkuar te na prezentoi dëshmi te transaksionit te pagesave mbi qiranë ( sipas Ligjit nr. 08/L-257 neni 6 paragrafi 9)*

➢ Ju nuk keni ofruar deshmi te kerkuara.

Keni dhene vetëm nje pergjigje qe jeni shprehur se keni arritur nje marreveshje gojore me qiradhenesin qe pagesat ti bejne ne fund te vitit, e qe bien ne kundershtim te plote me paragrafin III e kontrates mbi qirane.

Dhe

Sipas kerkeses per sqarime për qmime qe ne disa pozicione të ofertës konsiderohen shumë te larta me çmimet e tregut dhe në disa pozicione te ofertes ka çmime jo- normalishtë të ulta eshte kerkuar qe te na dëshmojë për secilin artikull nga tabela ne B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit se si ka arritur deri te çmimet e këtyre artikujve pasi qe këto çmime te ofruara nga ana e tij janë çmime shume te larta dhe çmime shumë të ulta ne krahasim me çmimet e tregut. Të ofroni dëshmi për këto çmime të ofruara në ofertën e juaj.

Nga deshmite e prezentuara nga :

- Oferta e Kompanisë BURAK e dates 06.12.2023,
- Oferta nga Team Glass System LLC te dates 20.11.2023
- Pro-Fatura nga Mega Auto Parts – Kosova te dates 15.11.2023
- Oferta nga Hidromek tebdates 13.12.2023
- Oferta nga Çukurova Makina Imalet veTicaret A.S. te dates 20.12.2023

Keto oferta dhe profature me pozicione te prezentuara si deshmi per qmime te ofruara jane te njejta me pozizionet e kerkuara nga ne per çmime abnormalishtë të larta dhe çmime abnormalishtë të ulëta permes kerkese per informata shtese te dates 07.06.2024.

Si te tilla konsiderohen si dëshmi jo reale dhe jashte çdo logjike per faktin se si munden me qene ofertat e kompanive me pozicionet krejtesishte te njejta me pozicionet e kerkuara nga ne permes kerkeses per informata shtese, kur ofertat ne fjale jane te nenshkruara dhe vulosura rreth 6 muaj para letres se sqarimit nga ana jone.

Dhe si te tilla konsiderohen si deshmi joreale per çmime te ofruara ne oferten e juaj.

Nga deshmite e prezentuara te OE Gazmend Bojku B.I nga :

- Profatura Euro Delta e dates 17.11.2023 jane prezentuar qmimete si vijon :

1. Vaj i ndruesit te shpejtesive eskavator per 1L çmimi pa TVSH eshte 15.25 € e qe me TVSH i bie 18.00 €
2. Antifriz 100% G12 per 4L çmimi pa TVSH eshte 4.19 € e qe me TVSH i bie 4.95 €
3. Vaj i ndruesit te shpejtesive per 6L çmimi pa TVSH eshte 8.47 € e qe me TVSH i bie 10.00 €
4. Vaj i timonit ATF per 3L çmimi pa TVSH eshte 8.47 € e qe me TVSH i bie 10.00 €
5. Vaj i frenave DOT 5-0.5L per 2 copë çmimi pa TVSH eshte 4.57 € e qe me TVSH i bie 5.40 €
6. Vaj i ndruesit te shpejtesive passat per 3L çmimi pa TVSH eshte 15.25 € e qe me TVSH i bie 18.00 €

Nëse bëjmë krahasimin e ketyre qmimeve me qmimet ne oferten e JUAJ shohim qmime abnormalishte të larta nga ana Juaj.

Shembull: Qmimi i antifrizit 100% G12 nga Eurodelta eshte per 4 L=4.95, kurse ne oferten tuaj 1 L antifriz 100% G12 çmimi i ofruar është 8.00 €, e ne disa edhe 9.74 €.

Shembull: Qmimi Vaj i timonit ATF nga Eurodelta eshte 3 L=10.00€, kurse ne oferten tuaj 1 L Vaj i timonit ATF çmimi i ofruar 17.70 €.

Shembull: Qmimi Vaj i frenave DOT 5-0.5L nga Eurodelta eshte 2 copë=5.40 €, kurse ne oferten e tij 1 Copë Vaj i frenave DOT 5 - 0,5 L çmimi i ofruar eshte 8.85 €, e ne disa edhe 12.00€.

Keto diferenca ne çmime verehen edhe ne produkte tjera te paraqitura ne kete profature.

Ju keni prezentuar deshmi (e- Fatura) në gjuhën Turke. Sipas LPP pranohen vetëm dokumente në gjuhën Shqipe, Serbokroate dhe Angleze.

Arsyeja e eliminimit në lidhje me kontratën për qira, është plotësisht e paqëndrueshme dhe e pabazuar në dispozita të LPP-së dhe e pa bazuar në fakte konkrete.

Fillimisht sqarojmë se në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar:
**2.Operatori ekonomik duhet te kete objektin – punetorine per servisimin dhe mirembajtjen te automjeteve jo me larg se dhjete (10) kilometra nga ndertesa e KRU Gjakova - Gjakove ose te ketë kontratë mbi qiramarrjen duke respektuar distancën**.

Ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar

**2.Nëse Objekti- punëtoria është ne pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit te pronësisë. Nëse objekti- punëtoria është marre me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës se qirasë si dhe kopjet e dokumentacionit të pronësisë së qiradhenënsit.**

Në lidhje me këtë kërkesë, ne kemi ofruar si dëshmi kontratën e dt.01.12.2023 për qira të objektit të lidhur me NTSH Autorservis Champion e cila është nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët. Kjo kontratë është valide për katër vite deri me dt.01.12.2027.
Duke pasur parasysh këtë kontratë, rezulton se është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit.

Me dt.07.06.2024 na janë kërkuar sqarime, ndërsa me dt.13.06.2024 kemi kthyer përgjigje të detajuara.

- Sa i përket kërkesës për sqarime ku është kërkuar që të prezantojmë dëshmi të transaksionit të pagesave me qira (sipas ligjit Nr.08/L-257 neni 6 paragrafi 9), ne e kemi sqaruar edhe në përgjigje me rastin e kërkesës për sqarime nga AK-së, prandaj edhe njëherë po e sqarojmë se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë si në vijim:

**2.Operatori ekonomik duhet te kete objektin –punetorine per servisimin dhe mirembajtjen te automjeteve jo me larg se dhjete (10) kilometra nga ndertesa e KRU Gjakova - Gjakove ose te ketë kontratë mbi qiramarrjen duke respektuar distancen**
**Dëshmi dokumentare**
**2.Nëse Objektipunëtoria Është ne pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit te pronësisë. Nëse objektipunëtoria është marre me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës se qirasë si dhe kopjet e dokumentacionit të pronësisë së qiradhenënsit.**

Ne, me dosje të tenderit e kemi ofruar kontratën për qira, e cila i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe këtë fakt e ka vërtetuar eksperti shqyrtues i OSHP-së në ekspertizën nr.2024/0094 të dt.07.03.2024 dhe më pastaj paneli shqyrtues i OSHP-së me vendimin nr. 2024/0094 të dt.28.05.2024.
Sa i përket çështjes së kontratës për qira, konsiderojmë se është **çështje e gjykuar** (res judicata) ky rast, kurse hapur shihet tendenca e AK-së ndaj kompanisë tonë. Kërkesa për të ofruar dëshmi të transaksionit të pagesave për qira, është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit, sepse nuk ka qenë kërkesë e specifikuar, prandaj nuk mund të kërkohet një dëshmi që nuk ka qenë kërkesë e FDT-së, prandaj eliminimi për këtë kërkesë është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse aty ceket qartë që operatorët ekonomik nuk mund të eliminohen për kërkesë që nuk janë përcaktuar në dosje të tenderit.

Me rëndësi është të plotësohen kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa çështjet tjera sikurse është marrëveshja me objektin me qira është çështje tjetër dhe është çështje e brendshme e qiramarrësit dhe qiradhënësit. Pra kjo çështje ka të bëjë me marrëdhënie kontraktuale

ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit, e që nuk hyn në kuadër të kërkesave të dosjes së tenderit.
Zbatimi ose jo i kontratës për qira është krejt çështje e brendshme e palëve. Mirëpo edhe për këtë çështje sa për korrektësi, i kemi sqaruar autoritetit kontraktues se ne kemi arrit një marrëveshje gojore me qiradhënësin që pagesat ti bëjmë në fund të vitit.
Duke pasur parasysh të gjitha këto dëshmi rezulton se arsyeja e eliminimit është plotësisht e paqëndrueshme dhe e pabazuar. Një konstatim të tillë e kishte dhënë edhe OSHP përkitazi me marrëveshjen për qiranë, prandaj kjo është **çështje e gjykuar dhe duhet detyruar autoritetin kontraktues të zbatojë vendimet e OSHP-së**.

- **Sa i përket çmimeve** ku janë kërkuar sqarime për të gjitha ato pozicione kemi konsideruar se nuk janë të gjitha ato pozicione për tu kërkuar sqarime për çmime jo normalisht të ulëta apo të larta, sepse të gjitha ato çmime dihet se janë çmime të përafërta me çmimet e tregut.

Vetë kërkesa e autoritetit kontraktues për të sqaruar tërë këto pozicione, më tepër ka tingëllu tendencioze dhe me qëllim të diskriminimit të kompanisë tonë, pasi që besojmë shumë, se edhe vetë autoriteti kontraktues përafërsisht i di të gjitha çmimet e tregut.
Po ashtu vlera e parashikuar e këtij tenderi është bërë pikërisht nga ana autoritetit kontraktues dhe oferta jonë është brenda kësaj vlere, që nënkupton se çmimet e ofruara nga ne janë çmime përafërsisht të tregut dhe janë të gjitha të arsyetuara.
Për çmimet të cilat i kanë konsideruar çmime abnormalisht të larta, sqarojmë se të gjitha ato çmime janë të përafërta me çmimet e tregut, ndërsa në këto raste duhet të merren parasysh tatimet, taksat dhe fitimi i kompanisë.
Ne, para se të vendosnim me ofertu në këtë tender, kishim bërë analiza të çmimeve të të gjitha produkteve dhe pjesëve e po ashtu kishim pranuar edhe Oferta nga prodhues të ndryshëm, e Distributor që janë në Kosovë për shitjen e pjesëve te Automjeteve, Kamioneve e Ekskavatorëve
Në çmime normalisht janë te përfshira edhe çmimi i furnizimeve te pjesëve dhe demontimi dhe montimi i pjesëve
**Pavarësisht këtyre dëshmive dhe fakteve, ne me sqarimet qw ja kemi dwrguar AK-sw, i kemi bashkangjitur ofertat e kompanive si në vijim:**

**· Ofertën e kompanisë BURAK të dt.06.12.2023 për kompaninë tonë.**
**· Pro faturën e kompanisë "EURODELTA SHPK" të dt.17.11.2023 për kompaninë tonë.**
**· Ofertën nga "TEAM GLASS SYSTEM L.L.C" të dt.20.11.2023 për kompaninë tonë.**
**· Pro faturën nga "MEGA AUTO PARTS"-Kosova të dt.15.11.2023 për kompaninë tonë**
**· Ofertën nga "HODROMEK" të dt.13.12.2023 për kompaninë tonë.**
**· Ofertën nga "Çukurova Makina Imalet ve Ticaret A.S" të dt.20.12.2023 për kompaninë tonë.**
**· Po ashtu kemi bashkangjitur edhe DUDA doganor si dëshmi importi për shumë pjesë, artikuj qe kompania jone importon nga shume vende të regjionit e Botes etj.**
**· E Bashkangjitur ka qenë edhe një tabel në Excel ku janë cekur pozicionet të cilat i kryen kompania jonë me ato çmime që janë dhënë tek përshkrimi i çmimeve dhe marrim përgjegjësi të plotë për këto pozicione, e normalisht që marrim përgjegjësi të plotë edhe për të gjitha pozicionet tjera.**
**Të gjitha këto dëshmi po ua bashkangjesim edhe me ankesë.**

Ne i kemi sqaruar AK-së se Bojku Hidraulik është kompani lidere për prodhimin e gypave, pistonave dhe shumë pjesëve të makinerive të rënda dhe të lehta dhe kemi kapacitet të plotë dhe staf profesional të bëjmë prodhimin e shumë artikujve e riparime dhe servisime për

makinerinë që e posedon Kompania KRU GJAKOVA e4dhe pse këtë fakt e din shumë mirë ky autoritet kontraktues.

Dëshmitë e ofruara nga ne, janë konsideruar jo reale nga ana e AK-së dhe jashtë çdo logjike.

Ky vlerësim i autoritetit kontraktues është më të vërtetë tendencë e hapur për të na eliminuar me çdo kusht, pasi që vlerësimet e tenderëve nuk lejohen të bëhen me supozime dhe me logjikë të ndonjë zyrtari tendencioz apo të ndikuar por vlerësimi i tenderëve bëhet mbi bazën e kërkesave të dosjes së tenderit dhe dëshmive të prezantuara nga operatorët ekonomik, prandaj kjo arsye eliminimit është shumë tendencioze, jo profesionale dhe subjektive dhe e pa mbështetur në ndonjë dispozitë të LPP-së.
Ne i kemi konfirmuar AK-së, se dëshmitë e ofruara nga ne me sqarime dhe të gjithë ofertat dhe profaturat që janë marr janë të qëndrueshme dhe kemi përkrahjen e plotë të të gjitha kompanive që janë përmendur në sqarime dhe dëshmitë që janë dorëzuar me sqarime janë plotësisht valide, prandaj arsyeja e eliminimit është plotësisht e paqëndrueshme dhe e pa bazuar.

- Sa i përket arsyes tjetër të eliminimit se ne kemi ofruar dëshmi/fatura në gjuhën turke, ju sqarojmë se kjo arsye është plotësisht e paqëndrueshme dhe e pa bazuar dhe për më tepër ne nuk e dimë se për cilën faturë bëhet fjalë.

Pra kemi një arsye të eliminimit të përgjithësuar dhe pa ndonjë specifikim të saktë, prandaj ne konsiderojmë se të gjitha dokumentet tona janë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Oferta jonë është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj arsyet e eliminimit janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara.

OE Ilir Noshi është i papërgjegjshëm me arsyet siç e ka cekur autoriteti kontraktues në letrën standarde për tenderues të eliminuar, prandaj këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore.

- *Tenderi i juaj* është administrativisht i papërgjegjshëm.

➢ *Me date 11.01.2024, ju kemi derguar permes e-prokurimit B41- Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, ku ju eshte kerkuar qe te ofroje deklarate me shkrim duke i zbërthyer në mënyrë <u>të detajuar</u> kalkulimin e çmimeve të paraqitura.*
*Ju jeni pergjigjur duke ofruar nje deklarate mirepo ne asnje moment nuk keni bere zberthimin ne menyre te detajuar te çmimeve per pozicionet qe ju kemi kerkuar.*
*Per kete arsye ne si AK bazuar ne nenin 41.10 te RRPP-se, paragrafi b-Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.*

- *Tenderi i juaj* është administrativisht i papërgjegjshëm.

➢ *Me date 11.01.2024, ju kemi derguar permes e-prokurimit B41- Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, ku ju eshte kerkuar qe te ofroje deklarate me shkrim duke i zbërthyer në mënyrë <u>të detajuar</u> kalkulimin e çmimeve të paraqitura.*
*Ju jeni pergjigjur duke ofruar nje deklarate mirepo ne asnje moment nuk keni bere zberthimin ne menyre te detajuar te çmimeve per pozicionet qe ju kemi kerkuar.*
*Per kete arsye ne si AK bazuar ne nenin 41.10 te RRPP-se, paragrafi b-Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulet", brenda dy dite nga data e vendimit te vleresimit te pare.*

OE **Fatmir Rudi B.I** është i papërgjegjshëm ashtu siç është cekur në letrën standarde për tenderues të eliminuar, prandaj arsyeja e eliminimit është edhe pretendimi i joni ankimor.

Arsyeja e eliminimit është si më poshtë:

- *Tenderi i juaj* është administrativisht i papërgjegjshëm:

➢ *Bazuar ne D01 Kodin Etik te Prokurimit, neni 5- Konflikti i interesit, pika 5.4- Janë tri pika të caktuara të një procedure të prokurimit publik, ku mund te lind konflikti i interesit, ku njera nder to eshte edhe mes atij qe ka përgatitur specifikimet teknike / dokumentet e tjera mbështetëse dhe tenderuesit.*
*Për qëllime të kësaj deklarate, individi konsiderohet se ka konflikt interesi kur individi, ose ndonjë anëtar familjeje ose bashkëpunëtor i tij: Mund të ketë ndonjë përfitim material financiar ose tjetër, nga posedimi i informacionit i cili është i natyrës konfidenciale. "Familja" e individit përfshin gruan, prindërit, vëllezërit dhe motrat, fëmijët dhe të afërmit tjerë.*
*Ne rastin tone, ju si OE ofertues jeni babai i inxhinierit i cili punon ne KRU 'Gjakova' sha dhe i cili ka bere pergatitjen e specifikimeve teknike, paramsen dhe parallogarine. Per kete shkak ne e kemi konsideruar si rast per konflikt interesi dhe eshte shpallur si i papergjegjshem.*

➢ *Ju nuk e keni vazhduar validitetin e tenderit sipas kerkeses se AK.*

➢ *Ju nuk e keni vazhduar sigurimin e tenderit sipas kerkeses se AK.*

Duke pasur parasysh të dy OE janë të papërgjegjshëm, atëherë rezulton se ne jemi ofertuesi më i lirë i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues i kësaj kontrate, mirëpo duke u pa qartë që ne duhet të jemi fitues, autoriteti kontraktues ka anuluar këtë tender edhe njëherë pa bazë ligjore.

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.02.07.2024.

Në lidhje me çështjen e kontratës, autoriteti kontraktues është përgjigjur si në vijim:

Ju ne oferten tuaj keni prezentuar kontrate mbi qirane e lidhur me 01.12.2023 me N.T.SH AUTOSERVIS CHAMPION. Ne paragrafin e pare te kesaj kontrate, figuron data 01/07/2019

Paragrafi IV i kesaj Kontrate mbi qirane sqaron:

Qiradhenesi N.T.SH. AUTOSERVIS CHAMPION eshte i obliguar qe nga data 01.12.2023 ta liroj lokalin (PUNTORINE MEKANIKE), siq eshte kerkuar nga qiramaresi NTP,,BOJKU

HIDRAULIK'' gjate bisedes verbale qe keni pas mes veti qe ne punetori te jene paisjet e nevojshme per kontrollimin dhe rregullimin e automjeteve te lehta dhe te renda.

Bazuar ne LPP, neni 52, paragrafi 7- Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit,

Duke u bazuar ne dispoziten e lartepermendur te LPP-se, si dhe nenin 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, ne si AK ju kemi kerkuar qe te prezentoni dëshmi te transaksionit te pagesave mbi qiranë ( sipas Ligjit nr. 08/L-257 neni 6 paragrafi 9), te cilen ju nuk keni arritur ta permbushni pasiqe nuk keni prezentuar asgje perveq qe keni cituar 'se keni arritur nje marreveshje gojore me qiradhenesin qe pagesat ti bejne ne fund te vitit', e qe bien ne kundershtim te plote me paragrafin III e kontrates mbi qirane te cilen e keni prezentuar.

Edhe nga kjo përgjigje e AK-së kuptohet tendenca e tyre për të na eliminuar nga konkurrenca dhe për të mos u shpallur fitues.
Në rastin konkret nuk ka asnjë dyshim në lidhje me kontratën për qira sepse kontrata është e nënshkruar nga dy palët dhe është valide, prandaj kjo kontratë është në fuqi dhe përmbush kërkesën e dosjes së tenderit, ndërsa në dosje të tenderit nuk është kërkuar që të ofrohen transaksione apo diçka tjetër në lidhje me kontratën por është kërkuar vetëm kontrata, ndërsa në këtë rast autoriteti ka bërë shkelje ligjore duke na eliminuar me këtë arsye.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor se jemi eliminuar pa të drejtë përkitazi me çmimet që janë konsideruar jo normalisht të ulëta, tej normalisht të larta dhe për fatura kinse në gjuhen turke, autoriteti kontraktues është përgjigjur si në vijim:

Lidhur me pretendimin tjeter ankimor qe ka te beje me çmimet, ju ri-kujtojme qe AK gjate administrimit të procedurave të prokurimit, e ka per obligim qe te luaje rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet.

Duke u nisur nga ky parim e qe eshte shume I rendesishem per ne si AK, kemi kerkuar nga ana juaj qe te ofroni deshmi për secilin artikull nga tabela qe ju kemi derguar permes letres standarde se si keni arritur deri te çmimet e këtyre artikujve pasi qe këto çmime te ofruara nga ana e juaj janë çmime shume te larta dhe çmime shumë të ulta ne krahasim me çmimet e tregut.

Nga deshmite e prezentuara nga juaj, ne si AK kemi vlersuar si ne vijim:

*Profatura Euro Delta e dates 17.11.2023 jane prezentuar qmimete si vijon :*

1. *Vaj i ndruesit te shpejtesive eskavator per 1L çmimi pa TVSH eshte 15.25 € e qe me TVSH i bie 18.00 €*
2. *Antifriz 100% G12 per 4L çmimi pa TVSH eshte 4.19 € e qe me TVSH i bie 4.95 €*
3. *Vaj i ndruesit te shpejtesive per 6L çmimi pa TVSH eshte 8.47 € e qe me TVSH i bie 10.00 €*
4. *Vaj i timonit ATF per 3L çmimi pa TVSH eshte 8.47 € e qe me TVSH i bie 10.00 €*
5. *Vaj i frenave DOT 5-0.5L per 2 copë çmimi pa TVSH eshte 4.57 € e qe me TVSH i bie 5.40 €*
6. *Vaj i ndruesit te shpejtesive passat per 3L çmimi pa TVSH eshte 15.25 € e qe me TVSH i bie 18.00 €*

*Nëse bëjmë krahasimin e ketyre qmimeve me qmimet ne oferten e JUAJ shohim qmime abnormalishte të larta nga ana Juaj.*

*Shembull: Qmimi i antifrizit 100% G12 nga Eurodelta eshte per 4 L=4.95, kurse ne oferten tuaj 1 L antifriz 100% G12 çmimi i ofruar është 8.00 €, e ne disa edhe 9.74 €.*
*Shembull: Qmimi Vaj i timonit ATF nga Eurodelta eshte 3 L=10.00€, kurse ne oferten tuaj 1 L Vaj i timonit ATF çmimi i ofruar 17.70 €.*
*Shembull: Qmimi Vaj i frenave DOT 5-0.5L nga Eurodelta eshte 2 copë=5.40 €, kurse ne oferten e tij 1 Copë Vaj i frenave DOT 5 - 0,5 L çmimi i ofruar eshte 8.85 €, e ne disa edhe 12.00€.*
*Nga deshmite e prezentuara nga vet JU ne tabelen e perpiluar ne excell jane paraqitur çmimet e njëjta si ne oferten e prezentuar per disa pozicione qe konsiderohen abnormalishtë të ulta. Kjo tabele nuk paraget asnje deshmi të argumentuar qe qmimet e paraqitura jane te bazuara ne qmimet e tregut. Por thjeshtë vetëm janë përshkruar edhe një herë qmimet e ofertuara për ato pozicione.*

*Ju nuk keni prezentuar asnje deshmi per Kategorine A (ne te cilen perfshihen : Servisimet e rregullta dhe Kontrolla e rregullt sipas Planit te servisimeve te rregullta), per te gjitha automjetet e paraqitura ne tabelë ,qmimet e të cilave konsiderohen abnormalishte te larta ne krahasim me qmimet e tregut., përveç ofertes nga "BURAK"*

*Sa i perket pjeses ku ju supozoni qe nuk keni prezentuar fature ne gjuhen turke, po ju ri-kujtojme 'e-faturen' si ne vijim:*

Tabela me pershkrime tek kjo fature eshte ne gjuhen turke qe ka qene e pakuptueshme per tu vleresuar nga komisioni I vlersimit si dhe ne kundershtim me LPP, pasi si gjuhe qe I njeh ligji jane: gjuha shqipe, serbe dhe angleze.

Duke u bazuar ne sqarimet e ofruara nga ana juaj lidhur me çmimet te cilat nuk ishin te plota dhe nuk keni ofruar deshmi te mjaftueshme, ne si AK kemi vepruar sipas nenit 41.10 te RRPP-se, paragrafi b-Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP,

"Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulet dhe jonormalishtë të lartë , brenda dy dite nga data e vendimit.

Me date 21.06.2024 eshte derguar ne KRPP, Letra B51- NJOFTIM PËR KOMISIONIN RREGULLTIVE TË PROKURIMIT PUBLIK- për refuzim të tenderit abnormalisht të lartë dhe abnormalisht të ulët.

Në këtë rast janë përsëritur arsyet e eliminimit dhe nuk ka asnjë argumentim i të kundërtës së asaj që pretendojmë ne dhe që i kemi dëshmuar me fakte konkrete.

Sa i përket tendencës për të konsideruar çmime abnormalisht të larta, e ku thuhet se ne nuk kemi ofruar asnjë dëshmi përveç ofertës nga Burak, sqarojmë se nuk ka asnjë bazë ligjore për të na eliminuar me një arsyetim të tillë. Çmimet tona janë çmime të përafërta me çmimet e tregut, prandaj janë ofruar edhe dëshmi por këto çmime dhe mund të verifikohen nga cili do që ka interesim për këtë çështje.
Çështja e çmimeve siç e quajnë autoriteti kontraktues abnormalisht të larta, për neve është shumë e paqartë se si vijnë në këto përfundime apo bëjnë interpretime të çmimeve sipas supozimeve, prandaj edhe kjo arsye e eliminimit është tendencioze dhe diskriminuese ndaj kompanisë tonë.

Sa i përket pretendimit për faturën që thuhet se është në gjuhen turke e ku është prezantu një foto, sqarojmë se në arsyen e eliminimit nuk është cekur decidivisht se cila është ajo fature, prandaj kjo përgjigje nuk korrespondon me arsyen e eliminimit dhe realisht nuk duhet të merret parasysh nga eksperti shqyrtues, mirëpo pavarësisht këtij fakti, ne përsëri nuk po kuptojmë se çka ka në këtë faturë në gjuhen turke dhe që nuk kuptohet.
Legjislacioni i prokurimit publik në raste kur ka ndonjë dokument në gjuhë jo zyrtare parasheh dhe lejon që të kërkohen sqarime shtesë, prandaj nëse eventualisht ka pasur ndonjë dilemë AK-së për ndonjë faturë, atëherë është dashur të kërkojë sqarime dhe ne do ta kishim ofruar të përkthyer atë dokument, e që normalisht jemi në gjendje ta ofrojmë në çdo kohë nëse kërkohen sqarime.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Mbi bazën e  këtyre sqarimeve dhe dëshmive të cekura më lartë rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Në këtë rast ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë por jemi diskriminuar.

Diskriminimi i kompanisë tonë vërehet qartë në veprimet e AK-së, që nga fillimi sepse në vlerësimin e parë vetëm për kompaninë tonë është shkuar tek objekti i marr me qira dhe kjo tregon se tendenca ka qenë të eliminohemi me çdo kusht, kur kem parasysh se të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e dorëzuara nga ne kanë qenë konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
**Kërkojmë nga OSHP-ja që të ketë paraysh  tendencat diskriminuese ndaj kompanisë tonë dhe qëllimin e AK-së që me çdo kusht të anulojë këtë aktivitet të prokurimit dhe të detyrojë AK-së që të respektojë vendimet e OSHP-së dhe dispozitat e LPP-së dhe të ndalet prolongimi i këtij procesi të prokurimit.**

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

**VENDIM**

| | |
|---|---|
| **I.** | **APROVOHET,** e bazuar ankesa e OE "***GAZMEND BOJKU B.I"*** |
| **II.** | **ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM |
| **III.** | **DETYROHET** AK-së  që ri vlerësimin e ofertave ta bëjë në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. |

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

| |
|---|
| Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 6,000.00 euro. |

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit  të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje  do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*